

PARIME TË MENHEXHIT QË DUHET T'I DIJË ÇDO SELEFIJ

Shejkh Ahmed bin 'Umer Bazmul



سلفي

SELEFI.ORG

Kurani dhe Suneti sipas kuptimit të Selefëve të këtij Umeti

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Të gjitha lavditë i takojnë Allahut. Atë e falënderojmë dhe prej Tij ndihmë dhe falje kërkojmë. Tek Allahu mbrohem nga të këqijat e veteve tona dhe nga veprat tona të liga. Atë që e udhëzon Allahu, s'ka kush ta devijojë dhe atë që Ai e devijon, nuk ka kush ta udhëzojë. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut, të Vetmit, të Paortak dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i Dërguari i Tij, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të dhe familjen e tij.

Fjala më e vërtetë është Fjala e Allahut dhe udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Muhamedit - lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të. Vepra më të këqija janë ato që shpiken në fe dhe çdo shpikje është bidat, çdo bidat është devijim dhe çdo devijim është në Zjarr.

Më tej:

Këtë ligjëratë që e mësojmë së bashku me vëllezërit tanë që janë nxënës dijeje nga vendet e ndryshme Islame, është një ligjëratë që përmban këshilla, së pari për veten time pastaj edhe për vëllezërit e mi. Pas ligjëratës *-in sha Allah* - do të kemi një grumbull pyetjesh. Kjo ligjëratë do të jetë - *me lejen e Allahut të Madhëruar e të Lartësuar* - plotësim i ligjëratës së djeshme, e ajo është me temë: **“Parime të Selefëve që Selefiju i ka për detyrë t’i dijë”**.

Nga çështjet e rëndësishme të cilat - *in shaa Allah* - do t’i nxjerrin selefijt prej shumë problemeve, është njohja e një parimi të rëndësishëm dhe njohja e një çështjeje të rëndësishme, e ajo është: Dallimi në mes shpalljes së një personi bidatçi (*tebdi'*) dhe paralajmërimit (*tahdhir*) dhe të dijë kur ndodh njëra e kur ndodh tjera.

Njohja e këtij parimi i nxjerr selefijt prej problemeve, sepse kur ti ndonjëherë paralajmëron kundër një personi, të thonë: “Ti e bën bidatçi atë”. Pastaj, e gjithë bota ngrihet kundër teje dhe të kundërshton dhe përplasat me ty.

Andaj, dijetarët *-Allahu i mëshiroftë-*, selefët e devotshëm - *Allahu qoftë i kënaqur me ta* - si dhe ata që ecin drejt menhexhit të tyre deri sot e kësaj dite, bëjnë dallim në mes shpalljes së një personi bidatçi dhe paralajmërimit kundër tij.

Shpallja e një personi bidatçi (*tebdi'*) është gjykim për një person se ka rënë në një bidat dhe obligohet paralajmërimi kundër tij. Kurse paralajmërimi (*tahdhir*) nuk është gjykim për një person se ka rënë në një bidat, porse ai është në një periudhë kundërshtimi

(ndaj menhexhit selefij) pasi që është këshilluar. Do të thotë se ai e ka kundërshtuar menhexhin selefij në disa çështje të cilat mund t'i jenë pështjelluar atij ose mund të jenë çështje në të cilat ka gabuar apo se ka ngulur këmbë në gabimin e tij, d.m.th. që në fillim. Atëherë, ata (dijetarët) paralajmërojnë për këtë njeri (duke thënë): “Kini kujdes nga filani prej njerëzve, mos u ul tek ai për të marr dije dhe paralajmërohet kundër tij derisa të pendohet dhe të kthehet. Dhe derisa të kemi një fjalë të qartë e të prerë të dijetarëve për të”. Cila është çështja e rrezikshme këtu? Çështja e rrezikshme këtu është në disa aspekte:

Aspekti i parë: ndodh kundërshtimi në mes të rinjve selefij për sa i përket miqësisimit dhe armiqësisimit (*el-Uela uel-Bera*) për këtë njeri. Disa prej tyre mendojnë se ti e ke bërë bidatçi atë dhe se e ke sharë atë, dhe si rrjedhojë e kësaj ndodh përçarje. Kjo është një çështje e rrezikshme.

Aspekti i dytë: disa të rinj - dhe këta janë pala tjetër - mendojnë se ai vazhdon të jetë “qendër” e dijes dhe vazhdon të jetë i besueshëm nga i cili përfitohet. Jo! Sepse ky njeri me këtë kundërshtim, është në një fazë ku duhet të heqim dorë prej tij dhe të largohemi prej tij, në mënyrë që të mos ketë ndikim tek të tjerët. Nëse ai pendohet, heq dorë dhe kthehet në hak, atëherë i kthehemi atij. Në qoftë se ngul këmbë, dijetarët gjykojmë për të duke e shpallur bidatçi apo të ngjashme.

Pra, për atë që është paralajmëruar, duhet t'i shmangesh atij, sidomos nxënësit e dijes të cilët nuk janë thelluar në dije, përse?! Ngase në këtë fazë, ky person ndaj të cilit është bërë paralajmërim është në mes dy gjërave:

Gjëja e parë: ose t'i kthehet hakut – *Allahu ia shpërbleftë me të mira*.

Gjëja e dytë: ose të ngulë këmbë në kotësinë (*batil*) e tij dhe të mos kthehet.

Po ashtu, në këtë fazë, ai do të përhap në zemrat dhe mendimet e të rinjve, parime dhe argumentime të dyshimta dhe do të mbjellë tek ata baza që do t'i bëjë ata të mendojnë se ai nuk është bidatçi dhe se ai nuk ka dalë nga menhexhi. Kështu që, nëse pas kësaj dijetarët e shpallin atë bidatçi, ata nuk pajtohen, sepse ai ka mbjellë në zemrat e tyre atë se këto fjalë që thuhet për të, nuk janë të vërteta.

Në rregull! A ta braktisim atë? Po! Braktiseni atë dhe largohuni. Nuk ka më mirë se shpëtimi, që të shpëtosh, të shpëtojë feja jote. Lavdi Allahut, dijetarët janë të pranishëm dhe nxënësit e dijes selefij janë të shumtë, në qoftë se nuk ka nxënës dije, atëherë ka kaseta dhe libra të selefijve. Allahu nuk e ka lidhur fenë pas individëve. Feja

dhe e vërteta ngelen - *me lejen e Allahut* - dhe nuk lidhen pas individëve. Njihe të vërtetën, do t'i njohësh edhe pasuesit e saj. Andaj, ky parim është shumë i rrezikshëm e që duhet t'i kushtojmë vëmendje.

Disa prej tyre vijnë e të thonë: “Filani nga njerëzit ka këtë e këtë”. E ai të thotë: “Deri më tani, dijetarët nuk e kanë bërë bidatçi”. Në rregull! Për atë se nuk e kanë shpallur bidatçi, kjo do të thotë se ai është në një fazë në të cilën ose do t'i kthehet të vërtetës ose do ta refuzojë atë. Kurse ti mundet që të mashtrohesh nga ai dhe të biesh në grackat e tij.

Andaj, ti e ke obligim nga ana e Sheriatit që të largohesh prej tij dhe të presësh fjalën e dijetarëve për të, a është në rregull që të kthehesh tek ai dhe të përfitohet prej tij apo që ta lëmë atë. A është e qartë tani se si është ky parim? Po ashtu, është obligim për sa i përket këtij parimi - siç u theksua dje - që mos të ketë fanatizëm dhe të mos ketë lidhje të hakut për individë. Çka është Halebiu?! Kuran?! Sunnet?! Selefus-Salih?! Ai s'është gjë. Nëse ai udhëzohet, e ka për të mirën e vetes së tij, e nëse devijon, i ka bërë dëm vetes, ndërsa e vërteta ngelet e palëkundur.

Që ta lidhësh të vërtetën (hakun) me Halebiun, nëse ai thotë diçka ta thuash edhe ti, e nëse refuzon diçka ta refuzosh edhe ti, duke mos iu referuar Kuranit dhe Sunetit, kjo është devijim. E si jo kur Halebiu tani, siç e dini, ta zëmë si shembull: ai ka rënë në çështjen e bashkimit të feve dhe se Islami mesatar me të cilin erdhi Pejgamberi – *lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të* – është ai Islam i cili i mbledh njerëzit tek parimi njerëzor, mos-dallimi dhe mos-përçarja. Kjo është dezertim dhe kufër në vete.

Megjithëkëtë fjala të pavërtetë (bashkimin e feve) në të cilën ka rënë Halebiu, prapëseprapë gjen disa apo shumë apo të gjithë, nga të dashurit e tij që e pasojnë atë, e mbrojnë atë. Dhe kjo u rithekson juve atë që u tha më parë, se ndaj atij nxënësi të dijes që është bërë paralajmërim - kurse Halebiu nuk është dijetar - për atë nxënës dije që është bërë paralajmërim, duhet që të largohesh nga ai në mënyrë që të mos sprovohesh me fitnen e tij.

Për këtë arsye, Shejkh Ahmed en-Nexhmi - *Allahu i Lartësuar e mëshiroftë* - çfarë ka thënë?! Ai ka thënë: “Ata të Shamit, i mbrojnë pasuesit e bidateve dhe nga të këtyllët nuk merret dija”. Pra, largohesh prej tij, pret që ai ose t'i kthehet hakut ose ta braktisë atë. Mos e lidh fenë tënde e as mos e lidh hakun që e pason, pas ndonjë individi.

Po ashtu fjala e Ibën Mes'udit - *Allahu qoftë i kënaqur me të* - me parimin (që u cek më lartë) është e ngjashme me këtë parim në vijim:

“Ai që do të pasojë dikë – ta marrë si shembull, të udhëzohet – le t'i pasojë ata që kanë vdekur – dhe ata që nuk kanë rënë në fitne janë Sahabët, Allahu qoftë i kënaqur me ta, – sepse i gjalli nuk ka garanci se nuk bie në fitne”.

Ky është një parim të cilin e ka thënë Ibën Mes'udi dhe Ibën Umeri - *Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë ata*. Kështu që, ku janë selefijt ndaj kësaj thënie? Disa prej tyre janë larg kësaj. Disa prej tyre e lidhin udhëzimin me filanin. Nëse ai udhëzohet edhe ata udhëzohen, e nëse ai devijon edhe ata devijojnë. Kjo është gabim. Ti me këtë që bën je mëkatar dhe ke përgjegjësi tek Allahu - *i Madhëruar dhe i Lavdëruar* -, sepse Allahu - *i Madhëruar e i Lavdëruar* - i ka bërë të vërtetës (hakut) pasuesë, gjurmë dhe shenja dhe i ka bërë të pavërtetës (batilit) pasuesë, gjurmë dhe shenja. Të ka urdhëruar që ta pasosh rrugën e vërtetë dhe të ka ndaluar që t'i pasosh qorrsokaqet e të pavërtetës.

وَأَنَّ هَذَا صِرَاطِي مُسْتَقِيمًا فَاتَّبِعُوهُ ۖ وَلَا تَتَّبِعُوا السُّبُلَ فَتَفَرَّقَ بِكُمْ عَنْ سَبِيلِهِ

*“Me të vërtetë kjo është Rruga ime e Drejtë, andaj ndiqeni atë dhe mos ndiqni qorrsokaqet të cilat ju shmangin juve nga Rruga e Tij (Allahut)”.*¹

Kjo është porosi nga Allahu - *i Madhëruar e i Lavdëruar* -, siç dihet.

Parimi i dytë - i cili është i njohur - porse duhet përsëritur dhe përkujtuar atë patjetër, ngase ne shohim që shumë të rinj selefij nuk e praktikojnë këtë dhe nuk e kuptojnë. Ose e kupton atë ose është i shkujdesur ndaj tij, andaj ne po u përkujtojmë.

وَذَكِّرْ فَإِنَّ الذِّكْرَ يَنْفَعُ الْمُؤْمِنِينَ

*“Dhe përkujto ngase me të vërtetë përkujtimi u bën dobi besimtarëve.”*²

Parimi i dytë: Sharja e Ehli Sunetit është sharje për ata që e mbartin Sunetin dhe ai që shanë Ehli Sunetin është bidatçi i devijuar.

¹ El-En'am, 153.

² Edh-Edhar'iat, 55.

Ai që shanë Ehli Sunetin duke synuar këtë gjë dhe duke e bërë qëllimisht, atëherë ai është bidatçi i devijuar. Ky është një parim i njohur dhe i palëkundshëm tek ne, por në zbatimin e këtij parimi shumë të rinj kanë mangësi.

Sa e sa të rinj dëgjojnë ata që shajnë disa dijetarë selefij, siç janë: Shejkh Ahmed en-Nexhmi, apo Shejkh Muhamed Aman el-Xhamij apo Shejkh Zejd el-Medkhalij, apo Shejkh Rabij el-Medkhalij, dëgjon sharje për disa dijetarë selefij porse nuk bën asgjë. Ndoshta sharja është e fshehtë, që nuk duket, kështu ai nuk bën gjë. Bile mund edhe t'i përsëris këto sharje duke patur parasysh që ai e din se sharja e dijetarëve të Sunetit është sharje e Sunetit dhe se ai që shan Ehli Sunetin qëllimisht dhe duke e synuar një gjë të tillë, është bidatçi i devijuar.

Kur njerëzit e dijes thonë: sharja ndaj disave prej Ehli Sunetit apo ndaj atyre që e mbartin Sunetin dhe e mbrojnë atë, është sharje ndaj Sunetit dhe është shpikje, a është kjo fanatizëm? Përgjigja është: jo! Ta marrim si shembull Shejkh Rabij el-Medkhalij. Kur ne kritikojmë dhe sulmojmë atë që e sulmon atë, a e kemi sharë atë që shanë Shejkh Rabij el-Medkhalij për shkak të personalitetit të Shejkh Rabijs? Apo për shkak të prejardhjes së Shejkh Rabij el-Medkhalij? Apo për ndonjë interes lekësh?

Shejkh Rabij el-Medkhalij - siç dihet - është një burrë që mbart Sunetin dhe e mbron atë, i refuzon pasuesit e bidatit dhe u është bërë halë në fyt - Allahu ia shpërbleftë me të mira. Ne e konsiderojmë të tillë dhe nuk pastrojmë asnjë para Allahut. Andaj, ne e kemi detyrë që ta mbrojmë dhe ta duam atë. Ta mbrojmë atë për shkak të mbrojtjes dhe dashurisë që ai ka ndaj Sunetit.

Pra, origjina e sharjes së atyre që shajnë dijetarë selefij është kjo (mbrojtja e Sunetit), jo fanatizmi për personalitetin e tij. Përndryshe, ju e dini se Halebiu - ta marrim si shembull - të rinjtë selefij e madhëronin Halebiun, e nderonin, por kur ai ra në devijime dhe bidate dhe në llumin e tyre, selefijt e sinqertë e braktisën, e armiqësuan, e refuzuan dhe i sqaruan devijimet e tij.

Në rregull! Kur e donin atë, mbajtën qëndrim dhe kur e urrenin atë, mbajtën qëndrim, cili është shkaku? Dashuria për hir të Allahut dhe urrejtja për hir të Allahut. Dhe ky është parim në bojkot (*hexhër*). Disa njerëz thonë: “Miqësimi dhe armiqësimi (*el-uela uel-bera*) nuk ka të bëjë me bojkotin”. Kjo është injorancë dhe devijim, ngase shkaku i bojkotimit të bidatçiut është dashuria për hir të Allahut dhe urrejtja për hir të Allahut. Pra, ti e urren atë për hir të Allahut - të *Madhëruar* e të *Lavdëruar* - ashtu siç i duam për

hir të Allahut selefijt dhe dijetarët selefij dhe nuk i duam për personalitetet e tyre. A është e qartë? Andaj kjo duhet vënë në pah.

P.sh. nga sharjet për Shejkh Rabijn dhe për dijetarët tjerë selefij është akuzimi i tyre për ashpërsi apo për pakujdesi, apo akuzimi i tyre se ata janë kritikues (xherhistë) dhe diktatorë, apo akuzimi i tyre se ata janë që numërojnë gabimet e të tjerëve apo se kanë ashpërsi. Sharjet e këtilla janë sharje për Ehli Sunetin.

Ne dhe ju e dimë se disa njerëz në Medine dhe gjetkë, e cilësojnë Shejkh Rabijn se ai është i ashpër, i pakujdesshëm, dhe disa dijetarë i cilësojnë se janë të kujdesshëm. Ky parim është i vërtetë me të cilin kihet për qëllim e pavërteta (batil). Dijetarët që flasin për çështjet e xherhit (kritikës) dhe t'adilit (lavdërimit) ndahen në tre kategori: *matesahilun* (tolerantë), *muteuasitun* (mesatarë) dhe *matesheddidun* (të ashpër).

Cili është kriteri në lidhje me mesatarët? (Përgjigja) është që shkak i xherhit dhe t'adilit të merret në konsideratë nga ana e Sheriatit, të jetë me hak dhe me argument dhe ngritje të argumentit për atë çështje të caktuar duke e përmendur shkakun. Xherhi dhe t'adili të jetë i tillë që merret në konsideratë.

Kurse toleranca (*tesahul*) është që t'i zë besë të panjohurve apo atyre që janë të kritikuar apo të ngjashëm. Kjo është tolerancë dhe zbutje ndaj të vërtetës.

Kurse ashpërsia (*tesheddud*) është: që kritikuesi (*el-xharih*) të kritikojë pa kurrfarë shkak, kjo është ashpërsia.

Në rregull. Të vijmë dhe ta zbatojmë këtë mbi dijetarët e njohur selefij. Kemi më të shquarin për këtë çështje, i cili shahet dhe flitet keq për të dhe është në qendër të sharjeve, e ai është Shejkh Rabij, dihet kjo punë. (Ata që e shajnë, sh.p.) janë: Halebiu, Maribiu, (Adnan) Aruri, Magraui, (Ibrahim) Rruhejli, filani...që të gjithë “rrotullohen” dhe duan që, kur të flitet për Shejkh Rabijn ta shajnë atë. Ata duan ta rrëzojnë atë në bashkëpunim me shoqatën “Ihjau-Turath” dhe të tjerë.

Të vijmë e të shikojmë Shejkh Rabijn - dhe kjo është përgjigja për një pyetje që u parashtrua - a cilësohet Shejkh Rabij me ashpërsi?

Unë them që të vemi e të shikojmë Shejkh Rabijn. Së pari: Shejkh Rabij kur kritikon ndonjë, e kritikon atë duke përmendur shkakun. Kështu që, o ti Magraui, o Maribi, o Arur, Shejkh Rabij të ka kritikuar në bazë të fjalëve të tua, audiove të tua të incizuara

dhe shkrimeve tua. Dhe ai (Shejkh Rabij) ka përmendur se ke thënë kështu, ke bërë kështu dhe çështja jote është kështu, etj.

Pra, a ka ardhur (Shejkh Rabij) të thotë se Maribiu është i kritikuar (*mexhruh*), përse o Shejkh Rabij? A do ta shikoje atë ta kruaj kokën (të mos dijë pse ka kritikuar, sh.p.)? Jo! Ai ta sqaron ty argumentin. Maribiu thotë se Ikhunaul-Musliminët dhe sektet e devijuara hyjnë tek Ehli Suneti dh se terminologjia e Selefizmit është me e hapur dhe e gjerë. Maribiu hyri në demokraci dhe hyri në shumë çështje që janë devijime, siç dihet. Dhe i cilëson dijetarët selefij se ata janë “konserva domatesh”, si dhe gjëra të tilla. Hizbijtë nuk e kanë cilësuar Ehli Sunetin me këtë, kurse ky Maribiu e cilëson Ehli Sunetin me këtë. Kështu që, Shejkh Rabij erdhi me argumente dhe fakte dhe bëri sqarim. Fjalët e tyre (dijetarëve selefij) janë argument kundër tij (Maribiut).

Së dyti: cili është qëndrimi i dijetarëve të Sunetit ndaj refuzimeve të Shejkh Rabijs? (Përgjigja) është se ata e lavdëruan atë dhe thanë se ai është muxhahid, nuk kritikon asnjë pa mos sqaruar shkakun dhe vërtetohet mirë në kritikën e tij. Ai nuk kritikon vetëm se pasi që i është bërë e qartë e vërteta dhe këshillon vazhdimisht para refuzimit dhe kritikës. Ai është një mbajtësi i flamurit në xherh dhe t’adil - siç e ka cilësuar Shejkh Albani. Kjo ishte e dyta.

E treta: ata që i ka kritikuar Shejkh Rabij, a është veçuar vetëm ai me kritikë ndaj tyre apo se edhe dijetarët janë pajtuar me të? Ma sill një person që Shejkh Rabij e ka kritikuar dhe asnjë nuk është pajtuar me të. Nuk gjen dot. Atëherë, Shejkh Rabij nuk veçohet në kritikë. A është e qartë kjo? Ata që e kanë kundërshtuar Shejkh (Rabijn) nga dijetarët për një kohë të caktuar, pas një kohe i janë kthyer fjalës së tij. Shembulli më i qartë për këtë është (Shejkh) Albani, i cili ka thënë për disa prej tyre që i ka refuzuar Shejkh Rabij, (Shejkh Albani) ka thënë: *“Shihet se dijetarët e Medines – ka për qëllim Shejkh Rabijn, Muhamed ibën Hadin, Shejkh Muhamed Aman el-Xhamijn, dhe tek këta futet edhe Shejkh (Ahmed) en-Nexhmi, Shejkh Zejdi ngase këta dolën të parët me refuzimet e tyre kundër njerëzve të pavërtetës (batil) – shihet se haku është me dijetarët e Medines për ato gjëra që i kanë refuzuar”*.

Edhe pse në fillim (Shejkh Albani) mendonte se kishte njëfarë ashpërsie (nga ana e tyre). Ky ishte Shejkh Albani, thuhet në lidhje me të ai parim që u përmend dje (në ligjëratë), e ai parim është: **Në qoftë se Dijetarët e Sunetit i mbrojnë njerëzit e bidatit, motivi i kësaj mbrojtjeje është se ata nuk e kanë studiuar gjendjen e tyre, nëse ata do**

ta kishin studiuar gjendjen e tyre, do ta sqaronin atë. Pra, Shejkh Albani u pajtua me atë që sqaroi Shejkh Rabij. A e kuptuat?

Së katërti: Sa është numri i atyre që i ka kritikuar Shejkh Rabij? (Përgjigja): Pesë?! Dhjetë?! Njëzetë?! Unë nuk mendoj se i kalojnë njëzet. Nuk mendoj. Shikoni dijetarët e Selefite, kanë kritikuar me qindra, madje me mijëra. Vjen te Shejkh Rabij i cili ka folur vetëm për disa persona të caktuar për një kohë të caktuar - e lusim Allahun që t'ia shtojë jetën e tij dhe bindjen ndaj Tij dhe ta bekojë e ta furnizojë atë me shëndet dhe mirëqenie dhe ta bëjë atë halë në fytin e bidatçijve - Shejkh Rabij i ka kaluar të tetëdhjetat, Allahu i Lartësuar e ruajttë. Përgjatë tetëdhjetë viteve nuk ka kritikuar vetëm se njëzet individë përafërsisht, thuaj edhe njëqind veta, a ka kritikuar shumë njerëz?! Jo. Nuk ka kritikuar shumë njerëz.

Po ashtu, ka nga atë që e kanë kuptuar të vërtetën për shkak të kritikës së tij (Shejkh Rabij), ngase ne nuk dijmë që Shejkh - Allahu i Lartësuar e ruajttë - të ketë bërë bidatçi ndonjë njeri apo ta ketë refuzuar atë, nuk dijmë që Shejkh të ketë gabuar në refuzimin e tij kundër tyre. Këtë nuk e dijmë. Edhe sikur të ndodh, nga ajo që dihet për gjendjen e Shejkh Rabijs është se ai kërkon falje dhe kthehet, edhe sikur të ndodh. Shejkh Rabij njihet për kthimin e tij në hak.

Pra, qëllimi me këtë (që thamë më lartë) është që t'i kushtohet vëmendje një çështjeje të tillë, t'i kushtohet vëmendje. Në rregull. Përse thonë se Shejkh Rabij është i ashpër? Edhe në qoftë se e ai sqaron gjendjen e tyre dhe i ka kritikuar ata, pasuesit dhe nxënësit e këtij (të kritikuarit) thonë se kjo është ashpërsi. (Ata thonë): "Pasha Allahun, filani është njeri i mirë, Shejkh Rabij është Selefij porse ai ka ashpërsi". O vëlla! Ki frikë Allahun. Shejkh është mesatar, nga të drejtët, nga mesatarët. Andaj, duhet patur kujdes ndaj këtyre çështjeve.

Pika që vijon apo parimi që vijon është: **Bërja dallim në mes refuzimit të një dijetari kundër të pavërtetës (batil) që bëhet për t'u refuzuar batili dhe në mes atij (dijetari) që refuzon nga haseti, apo është refuzim i ndërsjellë në mes bashkëkohësve apo është refuzim me pa të drejtë.**

Baza është që kur dijetari refuzon dhe sjell argument për refuzimin i cili merret në konsideratë, atëherë ne e pranojmë fjalën e tij. Ai refuzon nga haseti apo refuzon padrejtësisht, për këto nijete Allahu e din më së miri. Nëse dijetari e refuzon batilin, refuzimi i të cilit merret në konsideratë dhe që e kanë pranuar dijetarët, atëherë ai refuzim pranohet nga pikëpamja e jashtme.

Kur thuhet se ky refuzim është bërë nga haseti apo nga aspekti i të qenurit refuzim në mes bashkëkohësve apo se është bërë padrejtësisht? (Përgjigja): Sa i përket refuzimit të padrejtë është kur ai refuzon pa ndonjë shkak dhe flet kundër tij pa ndonjë shkak, kështu që kjo pa dyshim se është padrejtësi. Ti tani po e shanë atë dhe paralajmëron kundër tij, përse?! (Ai përgjigjet): “Ja kështu! Nuk më pëlqen ai”. Nuk të pëlqeka ty! Allahu nuk e ka bërë të keqen sipas mendjes tënde. Kjo është padrejtësi, ki frik Allahun për veten tënde! Nëse nuk sillen argumente dhe fakte për sharjet e ndereve të njerëzve, atëherë ato janë “të helmuara” dhe ti ke përgjegjësi për to. Po si është puna jote kur shanë dijetarët?! Si qëndron puna (kur shahen) nxënësit e rëndësishëm të dijes?!

Bie fjala: na vjen një person dhe na paralajmëron për Shejkh Abdullah Bukharin, përse po paralajmëron kundër tij? Cili është shkak? Ai nuk ka shkak. Kjo është padrejtësi. Shejkh Bukhari është i njohur, dijetarët e tij selefij prej të cilëve morri dije janë të mirënjohur, dihen shumë mirë lavdërimet e dijetarëve ndaj tij. Veprat, takimet, ligjëratat dhe daveti i tij për në menhexhin selefij të vërtetë janë të qarta dhe të shkoqitura. Nuk dijmë për të ndonjë kundërshtim ndaj hakut. Kështu që, ta shash atë është padrejtësi. Disa njerëz paralajmërojnë kundër këtyre selefijve.

Kurse ai që refuzon nga haseti shfaqet sikur ekzistojnë shkaqet e xherhit. Nuk ka xherh, porse ai flet. Në këtë rast, dijetarët e refuzojnë xherhin e këtillë dhe thonë: “Ki frik Allahun, ndoshta ke diçka personale me të (e jo për fe, sh.p.)”. Vërejeni se ata sqarojnë me argumente se ai ka rënë në haset dhe padrejtësi. Disa të rinj thonë se Shejkh Rabij, e filan shejkhu, filan shejkhu paralajmërojnë kundër një filan shejkhu, dhe thonë se e ka nga haseti. Pa mos dëgjuar se për çka flitet, cili është argumenti, as që e ka dëgjuar fjalën e Shejkhut. Kjo është gabim.

Së pari: nëse je njeri i thjeshtë, atëherë e ke detyrë që të kthehesh tek dijetarët e mëdhenj. Nëse je nxënës dije, atëherë e ke detyrë që të kërlesh argument. Jo që në fillim ta refuzosh atë (refuzimin e një dijetari për një tjetër, sh.p.). A është e qartë?

(Lloji) i tretë i refuzimit është refuzimi i ndërsjellë në mes bashkëkohësve. Ai refuzim është kur dy (dijetarë) janë të përafërt në moshë dhe dije. Duke i shtuar kësaj edhe atë që dijetari në refuzimin e tij të mos jetë i qartë për shkakun (e refuzimit). Ai refuzon kështu, thjesht. Këtu (dijetarët) thonë: shikoni tek përafërsia e tyre në moshë dhe dije, shtoja kësaj është mungesën e argumenteve në refuzim.

Por të më vish me Shejkh Nexhmin - *Allahu e mëshiroftë* - me tetëdhjetë vite e ca përmbi supe, dhe nga ana tjetër të më sjellësh Halebiun, Mesh'hurin dhe ata të Jordanit, e të më thuash: ky është refuzim në mes bashkëmoshatarëve. Këto fjalë janë të palogjikshme. Këtu flitet për një njeri që e refuzon hakun dhe nuk e do atë. Ku është ky krahasim në mes këtij dhe atij?! Kritika në mes bashkëmoshatarëve është që ata të jetë të përafërt (në moshe dhe dije). A është e qartë?

Në qoftë se një dijetar i madh e refuzon me pa të drejtë një nxënës dije të vogël, çfarë quhet kjo? A quhet refuzim në mes bashkëmoshatarëve apo diçka e tillë? Ne themi: ai cilësohet se është i padrejtë apo diçka e ngjashme, por nuk thuhet refuzim në mes bashkëkohësve. Ki kujdes ndaj kësaj.

Më mori njëri në telefon e më pyeti: “Cili është mendimi juaj për mospajtimin (khilafin) që po ndodh në mes dijetarëve të Jordanit dhe dijetarëve të Mbretërisë (Saudite)?” Unë i thashë: “O vëlla! Ki frikë Allahun! Ata të Jordanit nuk cilësohen se janë dijetarë porse ata janë nxënës dije, kurse dijetarët e Mbretërisë, siç janë Shejkh Rabij, Nexhmi, Shejkh Zejdi, dhe të tjerë, cilësohen si dijetarë për shkak të moshës, dijes dhe rrënjës së tyre në dije”.

Por të vish me nxënës dije dhe t'i cilësosh atë si dijetarë dhe të bësh krahasim në mes tyre, kjo është padrejtësi! E të mos përmendim se ata kanë rënë në gjëra që e kundërshtojnë menhexhin selefij, kështu që edhe sikur të ishin dijetarë të mëdhenj, nuk konsiderohen dijetarë para këtyre dijetarëve. Andaj duhet kushtuar vëmendje kësaj çështjeje.

Parimi që vijon më mbas është: **se dijetaret kanë nivele, pozita dhe grada.**

Ç'do të thotë ky parim? Ka prej dijetarëve që i dedikohen fik'hut, hadithit, bashkë me selefizmin e tij. Ka prej dijetarëve që i dedikohen refuzimit të njerëzve të bidateve dhe epsheve, ka prej dijetarëve që janë të angazhuar me gramatikën (Arabe), trashëgiminë dhe drejtime tjera. Andaj, ti duhet t'i njohësh dijetarët dhe nivelet e tyre.

Çfarë përfiton nga ky parim? Atë që përfiton nga kjo është se ti nuk vjen ta përplasësh fjalën e një dijetari që është i specializuar në xherh dhe t'adil dhe në refuzimin e njerëzve të së pavërtetës (*ehlul-batil*), nuk e refuzon këtë dijetarët për shkak të heshtjes së dijetarëve të tjerë. (Siç thonë): “O vëlla! Shejkh bin Bazi nuk e ka kritikuar këtë njeri! Shejkh Feuzani nuk e ka kritikuar filanin. Shejkh Abdul-Aziz Ali Shejkh nuk e ka kritikuar filanin!” O vëlla! Këta janë dijetarë selefij, i kemi si sytë e ballit dhe janë të

njohur, porse ata nuk u janë qasur këtyre fitneve dhe heshtja e tyre nuk do të thotë aprovim. Dhe kemi një parim të njohur: **Nuk i atribuohet një fjalë atij që hesht.**

Parimi tjetër: **Obligimi kolektiv (fard-kifaij) është që nëse disa e kryejnë këtë obligim, të tjerët janë të liruar nga ai mëkat.** Pra, dijetarët që refuzojnë njerëzit e të kotës (*ehul-batil*), kjo u mjafton edhe dijetarëve të tjerë. Dhe kjo ndërtohet mbi një parim tjetër që është obligim të dihet dhe ta përkujtojnë selefijt, ai parim është: **“Sqarimi i një dijetari të vetëm me xherh kundër një personi, mjafton.”** Nuk është kusht që të jenë dy apo tre apo të gjithë dijetarët të bëjnë xherh. Nëse sqarimi i tij është me hak, mjafton. Edhe sikur të heshtin dijetarët e tjerë.

Ti tani thua: “O vëlla! Filan Shejkhu akoma nuk ka folur! Filan Shejkhu nuk ka folur!” Sikur thua se për kritikimin e një personi duhet patjetër të flasin një grup dijetarësh. Kjo fjalë është e pabazë dhe është menhexh khalefij, e nuk është menhexh selefij. Pra, mjafton një dijetar i vetëm për refuzimin e të pavërtetës.

Kjo është pasqyra: një dijetar i specializuar refuzon dhe heshtin të tjerët. Pasqyra e dytë është: që të bëj xherh një person i kualifikuar dhe i informuar, dhe nga ana tjetër të lavdërojë një person që nuk është i kualifikuar në xherh apo se nuk ka informata për xherhin. Në këtë rast, mos i krahaso këto të dyja. Nëse lavdërimi (t’adil) i këtij dijetari është bërë pa mos e lexuar xherhin e një dijetari tjetër, në këtë rast, nuk krahasohen, ngase ai që e ka lavdëruar atë, ka parë vetëm gjërat që e lavdërojnë atë kurse ai që kritikon ka lexuar gjërat që e kritikojnë atë.

Vjen njëri e thotë: “Unë jam me filan Shejkhun që e ka lavdëruar filanin dhe nuk jam me filan Shejkhun siç është Shejkh Rabij, ngase njëri e ka lavdëruar kurse tjetri e ka kritikuar. Andaj, unë jam me këtë Shejkun e dytë”. Jo! E ke për detyrë që t’i njohësh nivelet e dijetarëve, kështu që ky është i kualifikuar dhe ky tjetri është i njohur tek njerëzit e thjeshtë që nuk janë nxënës dijeje.

Në qoftë se vjen një mjek i specializuar në kirurgjinë e zemrës dhe flet për një ilaç të caktuar dhe vjen një mjek tjetër i përgjithshëm që flet për një ilaç të zemrës, i cili duhet të ndërrohet me një ilaç tjetër, njerëzit e thjeshtë që nuk kanë dije e as Selefizëm, në parim, çfarë do thonin? Fjala e mjekut të specializuar ka përparësi. Ti lëmë anash njerëzit e thjeshtë, kjo është fjalë e dijetarëve. Parimi tek ata është: **Fjala e dijetarit të specializuar merret parasysh dhe me të gjykohet, si zakonisht gjatë mospajtimeve.**

Aspekti e tretë: Një dijetar e kritikon, kurse tjetri e lavdëron dhe thotë se kritika e dijetarit tjetër nuk merret parasysh. Dikush thotë: “Po! E di se filan Shejkhu e ka kritikuar, porse filani është sunnij”. Kjo këtu quhet përplasje e kritikës dhe lavdërimit. Aspekti i dytë është brenda këtij të tretit, porse ky është më i veçantë. Këtu quhet përplasje e kritikës dhe lavdërimit.

Cili është menhexhi selefij në këtë rast?! (Përgjigja): menhexhi selefij në këtë rast është që neve të vështrojmë, nëse kritika është e detajuar (xherh mufesser), atëherë ne e marrim ngase e kemi obligim. I kthehem atij sepse e kemi obligim dhe gjykojmë me të sepse e kemi obligim. Kurse dijetari që e ka lavdëruar atë, ka gabuar. Ai nuk shahet porse ka bërë përpjekje (ixhtihad) dhe ka gabuar. Natyrisht se dijetari nuk e ka lavdëruar duke u bazuar në epshe. Këtu kemi për të thënë diçka.

P.sh. nëse na vjen Shejkh Abdul-Muhsin el-Abbad dhe e lavdëron një njeri, nga ana tjetër atë njeri e kritikon Shejkh Ahmed en-Nexhmi apo Shejkh Rabij, ndërsa Shejkh Abbadi thotë: “Ai është sunnij edhe në qoftë se e kritikon filani”. Atëherë neve i vështrojmë të dyja fjalët, ku është argumenti i vërtetë, ku është fjala e hakut që ta pasojmë atë. A kritikohet Shejkh Abbadi? Jo! Shejkh Abbadi është dijetar selefij me peshë.

Si qëndron puna kur Halebiu e lavdëroi Maribiun, kurse Shejkh Rabij e kritikoi atë, a e shatë Halebiun?! Ka dallim këtu. Shejkh Abbadi në kohën që e lavdëroi Magrauin, e lavdëroi edhe Halebiu. Kur e lavdëroi Shejkh Abbadi atë, e lavdëroi meqë iu bë e qartë me ixhtihadin e tij se ai është në hak, e jo që të bazohet në epsh dhe nuk i është bërë i qartë atij e kota (batil) që ka Magraui. Ndërsa Halebiu e din tekfirin që bën Magraui, i di të fshehtat e Magrauit, përzihet me Magrauin dhe thotë se unë jam më i dituri nga njerëzit për Magrauin. Atëherë, Halebiut i është ngritur argumenti, dhe i është bërë i qartë haku, porse ai (Halebiu) ngul këmbë në të kotën e tij.

Andaj, kjo bazohet në një parim tjetër, e cila është: **bërja dallim në mes atij që ka rënë në batil pa dashje dhe në mes atij që ka rënë në batil me dashje.** Pra, ai që ka rënë në gabim pa dashje, nuk kritikohet. Atij i sqarohet dhe bëhet durim ndaj tij. Kurse ai që ka rënë në batil me dashje dhe këmbëngulje pasi që i është bërë e qartë, ai kritikohet dhe nuk ka nderë për të. Në këtë rast, i japim përparësi kritikës.

E gjithë kjo bazohet në një parim që duhet kushtuar vëmendje bashkë me atë që është cekur më parë, e ajo është: **Nuk është e saktë dhe nuk lejohet në menhexhin e selefëve që mospajtimin në mes dijetarëve në lidhje me kritikën e një personi dhe**

besueshmërinë së tij, ta bëjë arsye për të pasuar batilin pasi që i është bërë i qartë haku.

Ndërsa në zbatim të këtij parimi shohim se disa të rinj selefij e pasojnë Maribiun dhe e pasojnë atë të cilin e konsideron atë të besueshëm. I thua atij: “O vëlla! Ki frikë Allahun! Dijetarët e kanë bërë Maribiun bidatçi”. Ai të ta kthen: “Megjithatë, filan Shejkh ka thënë se është sunnij, selefij”. I thua: “O vëlla! Maribiu thotë kështu e kështu dhe kjo është batil apo nuk është batil?” Të thotë: “Po! Është batil”. Maribiut i është ngritur argumenti dhe e kanë refuzuar dijetarët, apo jo? Të thotë: “Po”. E ti i thua: “Atëherë, ti e ke për detyrë që ta braktisësh atë”. Të thotë: “Jo! Unë pasoj filan Shejkh i cili e ka lavdëruar atë, ky është justifikimi im”.

Jo! Përderisa e din hakun nga batili, nuk të lejohet që ta marrësh mospajtimin e dijetarëve si argument për ty dhe të justifikohesh për ta pasuar të kotën. Atëherë, ti je mëkatar nëse e pason të kotën pasi që e dije. A është i qartë ky parim tani? Ky parim është i rëndësishëm dhe shumë prej të rinjve argumentohen me këtë të kotë. U vjen atyre një person i cili ka dalë në krye të davetit dhe ata e vijnë tek ky dhe e pyesin: “Filani ka bërë bidatçi filanin dhe e ka lavdëruar filani”, e ai i përgjigjet: “Mbaroi kjo punë! Përderisa ti e pason filanin, kjo është justifikim për ty”. A e shikon se çfarë parimesh u shpik atyre?

Kurse në menhexhin selefij kjo nuk qëndron. A të është bërë i qartë ty haku? A mësove se me kë është haku? A e kërrove hakun? A je kthyer tek dijetarët e kualifikuar? Ai që ka bërë kritikë, a është ajo e detajuar (xherh mufesser)? Këto gjëra nuk janë me përgjithësi. Për këtë arsye, nga parimet e pasuesve të kotës siç është përmendur këtu është: Pështjellimi me shprehje të përgjithshme. Andaj, këto janë prej parimeve të pasuesve të kotës, andaj duhet kushtuar vëmendje kësaj. Përmes përgjithësimeve dhe absolutizmave, ta kalojnë ty batilin. Kështu që, selefiju duhet të bëjë kujdes ndaj këtij parimi të kotë dhe të jetë i zgjuar në mënyrë që mos ta kundërshtojë menhexhin selefij në të cilin ecën.

Çështja e fundit është: që t’i japin rëndësi dijes, mësimdhënies dhe kthimit tek dijetarët dhe nxënësi i dijes fillestar të mos dal në krye (të davetit) apo ai që nuk është i kualifikuar për xherh dhe tadil.

Të mos dal në krye duke folur për çështjet e xherhit dhe tadilit. Të mos shpall dikë bidatçi apo të devijuar, kjo çështje u takon dijetarëve dhe atyre nxënësve të dijes që janë të kualifikuar.

Cili është qëndrimi im (i një selefiju)? A të hesht? Të mos e kritikoj Maribiun?! Të mos e kritikoj filanin? Ne themi: këtu ka dallim. Nëse dijetarët e kanë kritikuar ndonjërin, atëherë ti kritikojë atë duke transmetuar fjalët e dijetarëve. Ky Maribiu shanë Shejkh Zejd el-Medkhali, Shejkh Nexhmin, Shejkh Rabijn, Shejkh Abdullah Bukharin, Shejkh Muhamed ibën Hadin. Ti transmetoi fjalët e dijetarëve por mos fillo të bësh debat përderisa ti je nxënës dije. Ti u sqaron atyre me fjalët e dijetarëve. Nëse ai nuk i pranon fjalët e dijetarëve, atëherë as edhe fjalët e tua nuk do t'i pranojë.

Rreziku këtu është se ti je nxënës dije dhe ndoshta nuk posedon argumente, kurse armiku yt vjen me argumente që të fut në dyshime. Ku është qëndrueshmëria në fe? Ku është gjykimi i drejtë? Ku është devotshmëria? Ku është frika nga Allahu? Ai të lëkund ty dhe i lëkund bindjet që ke ti. Jo! Mos u zhyt në debat, dhe ky është paralajmërimi i dijetarëve selefij që të mos flasin për xherh dhe tadil, jo se ata të mos i paralajmërojnë të rinjtë nga transmetimi i fjalëve të dijetarëve për ata që janë kritikuar. Disa ua mohojnë të rinjve selefij transmetimin e fjalëve të Shejkh Rabij apo Shejkh Nexhmit apo filanit e filanit kundër Maribiut, Halebiut apo ndonjë tjetri.

Ai të thotë ty: “O vëlla! Dijetarët kanë paralajmëruar për këtë (transmetimin i fjalëve të dijetarëve për një person të caktuar)”. Jo! Ata nuk kanë paralajmëruar nga transmetimi i hakut dhe nuk kanë paralajmëruar që të mos paralajmërosh për batilin. Porse ata të kanë paralajmëruar ty o nxënës i dijes fillestar dhe o ti që nuk je i kualifikuar, që të zhytesh në xherh dhe tadil para se të jesh i zoti për atë dhe të mos u paraprish dijetarëve. Dallimi në mes këtyre dyjave është çështje e rëndësishme.

Me kaq mjaftohemi me këtë ligjëratë. Lavdërimet dhe shpëtimi i Allahut qoftë për Pejgamberin tonë Muhamedin, për familjen e tij dhe për të gjithë shokët e tij.

Burimi: <http://www.sahab.net/forums/index.php?showtopic=112769>

Përktheu: Jeton Shasivari

10 Muharrem 1436 H

3 Nëntor 2014

Medine